



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-82835/22 dt. 14.04.2022, parashtruar nga “HIB Petrol” shpk, me pronar Ibrahim Bucaliu nga Ferizaji dhe pronarit Ardian Karaxha nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa afariste me karakter të përkoshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, ndërtuar në Çagllavicë, në rr. “Gjilani”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit të Komunes së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 01.08.2022, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuarve “HIB Petrol” shpk, me pronar Ibrahim Bucaliu nga Ferizaji dhe pronarit Ardian Karaxha nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-82835/22 dt. 14.04.2022, përdorimi i kompleksit të ndërtesa afariste me karakter të përkoshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, me etazhitet P+0, e ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e ndërtimit të ndërtesës afariste të karakterit të përkoshëm 05 Nr. 351-134359/20 dt. 25.09.2020, në parcelën kadastrale nr. 1840-0, ZK Çagllavicë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Gjilani” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numër: 49 në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës me karakter të përkoshëm në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Aplikuesit “HIB Petrol” shpk, me pronar Ibrahim Bucaliu nga Ferizaji dhe pronarit Ardian Karaxha nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-82835/22 dt. 14.04.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e lejes së përdorimit për kompleksin me ndërtesa afariste me karakter të përkoshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, me etazhitet P+0, e ndërtuar në Çagllavicë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1840-0, ZK Çagllavicë, ndërtuar sipas Vendimit për Lejimin e ndërtimit të ndërtesës afariste të karakterit të përkoshëm 05 Nr. 351-134359/20 dt. 25.09.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-235015/20 dt. 30.03.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Gazmend Vranovci; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Berat Hajdini; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Faton Frangu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Burim Hyseni; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Arben Sahiti; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht kompleksi i ndërtesave afariste me karakter të përkoshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market, mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa afariste me karakter të përkoshëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa afariste me karakter të përkoshëm dhe me destinim-përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës dhe market.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-82835/22 DT. 01.08.2022**

Zyrtarja,  
Bahtije Vilasaliu

*Bahtije Vilasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi

Faqe 2 prej 3

Komuna e Prishtinës-Drejtorja e Urbanizmit  
Adresa: rr "Radovan Zogoviq" nr 1, 10000, Prishtinë-Kosovë

